



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/15, qershor 2008), dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-076, për policinë, dispozitave të neneve 3 dhe 4 të Udhëzimit administrativ nr. 27/2012, MPB-03/2012 MAPL, për këshillat komunalë për bashkësi, si dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT
PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

I

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, nr. 01-020/01-62792/22, dt. 21.03.2022.

II

Në pikën II të vendimit të cekur si në pikën I të këtij vendimi,

1. Në vend të Diana Sadikut, përfaqësuese e KLSP-së “Kalabri”, është zgjedhur Hilmi Halili.
2. Në vend të Altin Gashit, përfaqësues i KLSP-së “Hajvali”, është zgjedhur Xheladin Fazliu”.
3. Caktohen anëtarët e ri të Komitetit Lokal për Siguri Publike, Naim Bajraktari, përfaqësues i KLSP-së “Ulpian” dhe “Kodra e Diellit”, dhe Genta Osmani, përfaqësuese e KLSP-së “Lagjja e Spitalit”.

III

Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit nr. 01-020/01-62792/22, dt. 21.03.2022.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/01-86548/23, më 02.05.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

